

Nr. K4/E3-24 Prot.

Tiranë 10/12/2025

Nr.202503309/ Dok.

Lënda: Rekomandime për punonjësit e policisë së shtetit: *"Marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të të tjerëve, në zbatim të ligjit nr. 82/2024 për Policinë e Shtetit".*

Drejtuar: **Z. Ilir PRODA**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Komisariatit nr.4

TIRANË

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni nëpërmjet, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë nëna e shtetasit Gentian Sorra e cila në ankesë pretendon se djali i saj është dhunuar nga punonjësit e policisë brenda Komisariatit Nr.4, Tiranë dhe për këtë shkak është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë në gjendje të rëndë shëndetësore.

Lidhur me ngjarjen Nd/Komisionerët e Institucionit të Avokatit të Popullit përkatësisht Mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës trajtimin të egër çnjerëzor dhe degradues, filluan hetimin administrativ të çështjes. Në dt. 15.09.2025, u krye një inspektim në Komisariatit e Policisë nr.4 Tiranë, në kuadër të monitorimit të respektimit të të drejtave të njeriut për personat e shoqëruar/ ndaluar nga organet e policisë së shtetit.

Përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit përgjatë inspektimit administruan, deklaratat e punonjësve të policisë të cilët ishin të pranishëm përgjatë shoqërimit të shtetasit Gentian Sorra si dhe siguruan kopje të regjistrit të personave të shoqëruar, formularin e raportit e shoqërimit si dhe këqyrën ambientet e shoqërimit si dhe zyrën e punës së SPZ- ve.

Në Komisariatit e Policisë nr. 4 në Tiranë punonjësit e policisë të pyetur nga ana jonë, deklaruan se në datën 15 Shtator 2025, rreth orës 15.00 është paraqitur në Komisariatit e Policisë shtetësia Ilda Sorra me qëllim për të bërë kallëzim penal ndaj bashkëshortit të saj, shtetasit Gentian Sorra, i cili e kishte sharë dhe kërcënuar. Punonjësit e policisë me marrjen dijeni kanë telefonuar shtetasin Gentian Sorra për tu paraqitur pranë Komisariatit nr.4, Tiranë për sqarimin e situatës. Punonjësit e policisë deklarojnë se gjatë telefonatës me shtetasin Gentian Sorra ky i fundit ka qenë me tona të larta dhe ofenduar punonjësit. Pas një difference kohe të shkurtër shtetasi Gentian Sorra u paraqit në Komisariat dhe morri kontakt me punonjësit e policisë me të cilët ka kundërshtuar faktin e thirrjes së tij në komisariat. Përgjatë shoqërimit të këtij shtetasi drejt ambientit të zyrës ku plotësohen raportet e shoqërimit, por në atë dhomë ndodhej një shtetase Ukrainase dhe Shtetësia Ilda Sorra bashkëshortja e shtetasit që shoqërohej, për të qetësuar situatën punonjësit e policisë vendosën ta shoqëronin shtetasin Gentian Sorra për tek dhoma e SPZ.

Dhomë e cila përdoret për intervistimin e personave të shoqëruar ose të dyshuar për ndonjë vepër penale. Gjatë kalimit në korridor shtetasi Gentian Sorra ka kundërshtuar dhe shtyrë me duar punonjësit e Policisë, pamje të këqyrura në kamerat e Komisariatit nr.4, e më tej ai u fut brenda dhomës, dhe tek tavolina në krahun e majtë ku nga agravimi dhe gjendja e dehur në të cilën ndodhej ai është penguar dhe është rrëzuar në tokë. Sipas deklarimeve të punonjësve të policisë menjëherë këtij shtetasi ju dha ndihma e parë mjekësore, pasi personi nuk po përmendej nisur dhe nga gjendja e dehur në të cilën personi ndodhej. Pas dhënies së ndihmës së parë mjekësore është lajmëruar urgjenca e cila e transportoi shtetasin drejt Spitalit Universitar Tiranë, për marrjen e ndihmës mjekësore. Vlen të theksojmë se nga pamjet filmike shoqërimi nga ana e punonjësve të policisë duket korrekte.

Referuar nenit 25, pika 4, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, përcaktohet se: *“Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës. 2. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t’i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të të tjerëve”*. Si dhe në nenin 9, *“Përgjegjësitë*

e Policisë së Shtetit 1. Policia e Shtetit ushtron përgjegjësitë: a) mbron jetën dhe shëndetin e personave”.

Gjithashtu në procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022” në pikën.6 “Zbatimi i të Drejtave të Njeriut dhe Siguria për Personin e Shoqëruar” përcakton se: Në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimit human në këto ambiente.

Referuar Vendimit nr. 112, të Këshillit të Ministrave, datë 24.2.2025 të “Për Miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” në nenin 19, pika 6 “Mbajtja dhe trajtimi i personave të ndaluar përkohësisht” përcakton se: “Policia e Shtetit është përgjegjëse për garantimin e jetës dhe të shëndetit të këtyre personave gjatë mbajtjes dhe trajtimit në ambientet e Policisë.”

Duke mbajtur në konsideratë natyrën e çështjes, në raste të tilla shërbimet e policisë, mund ta parandalonin këtë ngjarje, në kushtet e veprimeve apo mosveprimeve që përfaqësuesit e rendit publik kishin si detyrim të kryenin.

Në rastin e shoqërimit të shtetasit Gentian Sorra, sipas deklaramentit të punonjësve të policisë qytetari kur është paraqitur në komisarariat ka qene ne gjendje të dehur dhe të agravuar. Në këtë rast punonjësit e policisë nuk kanë vepruar referuar procedurës standarde.

Avokati i Popullit vlerëson të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë ***kryerjen e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.***

Avokati i Popullit për të bërë të mundur shqyrtimin e hetimit administrativ të rastit, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, germa “b” ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, në

nenin 20 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”, i është drejtuar me kërkesë për informacion institucioneve:

Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë me shkresën nr. K4/E3-4 prot., datë 19.08.2025, “Kërkesë për vënien në dispozicion të pamjeve filmike të kamerave”, Spitalit Universitar të Traumës me shkresën nr. K4/E3-5 prot., datë 19.08.2025, “Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjes së kartelës mjekësore të shtetasit Gentian Sorra”, Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë me shkresën K4/E3-6 datë 19.08.2025, “Kërkesë për dokumentacion dhe informacion”, Institutit të Mjekësisë Ligjore me shkresën nr. K4/E3-14 prot., datë 11.09.2025, “Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjeve të ekspertizës mjeko-ligjore të shtetasit Gentian Sorra” dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. K4/E3-2 prot., datë 19.08.2025, “Kërkesë për shpjegime”. Sa më sipër në përgjigjet e tyre institucionet na bëjnë me dije se:

Me shkresën nr. 8658/2 prot., datë 11.09.2025 Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë na bën me dije se në lidhje me rastin verifikimet po kryhen nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.

Me shkresën nr. 3254/1 prot., datë 28.08.2025, “Kthim përgjigje”, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore na bën me dije se, me marrjen dijeni nga familjarët e shtetasit Gentian Sorra se ky i fundit është dhunuar në ambientet e brendshme të Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë, kanë kryer veprime procedurale nën drejtimin e organit procedural të hetimit dhe materialet janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Më shkresën nr. 14711/1 Prot., datë 31.10.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë na konfirmon se ka regjistruar kallëzimin penal nr.13551 viti 2025, për veprën penale “Dhuna në familje”, dhe mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik” ku shtetasi Gentian Sorra rezulton i kallëzuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Gjithashtu me shkresën nr.93225/1 Prot., datë 08.10.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë na bën me dije se ka regjistruar procedimin penal nr. 7317, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar si krim nga neni 250 i Kodit Penal.

Me shkresën nr. 8479/5 Prot., datë 23.09.2025, “Kthim përgjigje”, Instituti i Mjekësisë ligjore përkatësisht sektori i menaxhimit të akteve të ekspertimit dhe laboratorit ka përcjellë “Aktin e Ekspertimit Mjeko-Ligjor nr.2299,Dc datë

22.09.2025”. Në shkresë na bëjnë me dije se ekspertimi- mjekoligjor i është dërguar Prokurorisë pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nëpërmjet aktit të ekspertimit arrijnë në konkluzionet se: Në trupin e shtetasit Gentian Sorra u konstatua prani gjaku poshtë cipës së fortë të trurit në regjionin fronto- parietal të djathtë, kontuzion i trurit në regjionin temporal të djathtë, hemorragji mes cipave të buta të buta të trurit, thyerje e kockës së mesme të majtë të bazës së kafkës, hemorragji në veshin e majtë, plagë në lëkurën e kokës. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të rënda pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit të tyre.

Me shkresën nr.3229/3 prot., datë 03.09.2025, “Kthim përgjigje”, Spitali Universitar i Traumës na bën me dije se, më datë 15.08.2025, shtetasi Gentian Sorra është paraqitur në urgjencë me diagnozë pranimi “Hemorragji Subdurale Traumatike”.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit problematikat e konstatuara janë:

- ✓ *Gjatë shoqërimit personi nuk është dërguar në dhomën e ndalimit të përkohshëm për të rritur ndonëse punonjësit e policisë kanë konstatuar gjendjen e agravuar të shtetasit Gentian Sorra por e kanë drejtuar atë në zyrën e SPZ-ve për ta intervistuar, e cila solli më pas pasojat e saj.*
- ✓ *Ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre në momentet e para të shoqërimit në ambientet e Policisë së Shtetit.*

Sjellim në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë që prek kufijtë e lirisë së tij dhe kërkon respektim maksimal të drejtave themelore të njeriut nga njëra anë dhe nga ana tjetër respektimin të detyrave ligjore nga organet e Policisë së Shtetit. Kjo situatë duhet qartësuar ligjërisht dhe faktikisht në mënyrë që çdo palë që përfshihet në të, si qytetari ashtu edhe punonjësi i policisë të ruajnë ekuilibrin individ-shtet për të shmangur abuzimet dhe torturën. Tortura¹ është një nga shkeljet më serioze të një personi që i shkelen të drejtat. Mund të shkatërrojë dinjitetin, trupin dhe mendjen e një personi dhe të ketë larg efektet në shoqëri, megjithë ndalimin e tij absolut sipas ligjit.

Lidhur sa më sipër, sqarojmë se kjo çështje tashmë është në juridiksionin e organeve

¹ Për të mënjeluar çdo dyshim, ankuesi nuk ka pasur ankesë për veprime të dhunshme nga ana e punonjësve që e kanë shoqëruar

të drejtësisë dhe Avokati i Popullit nuk shprehet më tej për rastin, por theksojmë se shkaqet që kanë çuar në këtë ngjarje tregojnë mangësi strukturore të cilat kanë nevojë të adresohen.

Abuzimet nga policia mund të ndodhin për shumë arsye, sepse përdorimi në përputhje me parimin e proporcionalitetit nuk është një detyrë e lehtë.

- Shkeljet e të drejtave të njeriut mund të vijnë nga një vlerësim i gabuar i një situatë të caktuar.
- Abuzimet mund të ndodhin edhe kur punonjësit e veçantë të policisë përfitojnë nga fuqia e tyre duke ushtruar forcë të tepruar për të frikësuar, marrë informacionin ose për arsye të tjera.
- Mund të jetë gjithashtu sfiduese situata për monitoruesit që kërkojnë të adresojnë torturat ose keqtrajtimet e tjera sepse ekziston një kulturë e pandëshkueshmërisë në një kontekst të caktuar: në raste të tilla, oficerët e policisë që kryejnë shkelje të të drejtave të njeriut e dinë që do ta bëjnë këtë të mos ndiqen penalisht ose të dispiñohen.
- Përveç përdorimit të forcës, fushat kryesore të rrezikut përfshijnë mënyrën e kufizimit që janë përdorur, si kryhen kërkimet dhe nëse janë diskriminuese. Rreziqet e abuzimit në paraburgim policor janë veçanërisht të larta gjatë orëve të para paraburgimi, kjo është koha kur të paraburgosurit janë më të rrezikuar dhe kur zyrtarët janë nën presionin më të madh për të siguruar informacione prej tyre.

Për të evidentuar të gjitha situatat në shkelje të ligjit, duhet të respektohen masat mbrojtëse që në momentin fillestar të aplikimit të ligjit nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet.

Masat mbrojtëse kryesore përfshijnë:

- dhënia e informacionit për të shoqëruarit për të drejtat e tyre,
- sigurimin e aksesit të një avokat,
- duke njoftuar anëtarët e familjes dhe / ose një palë të tretë për personin
- dhënia e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar të jetë e mundur pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.

Kështu, përveç ndihmës për të parandaluar abuzimet, masat mbrojtëse të integruara nuk duhet të zvogëlohen por duhet të jenë sa më korrekte dhe të ushtruara në kohë. Kjo problematikë kërkon vëmendje të veçantë edhe nga faktori ndërkombëtar i cili i ka kushtuar rëndësi parësore të drejtave themelore të njeriut.

Këshilli i Evropës ka një fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të drejtat e personave të shoqëruar apo të ndaluar nga policia. Këto standarde janë pjesë e përpjekjeve më të gjera për të mbrojtur të drejtat themelore të qytetarëve dhe për të siguruar që shtetet anëtare të ndjekin praktikatat më të mira në sistemet e tyre të drejtësisë.

Në raport me Këshillin e Europës, disa prej udhëzimeve dhe dokumenteve të rëndësishme që prekin të drejtat e personave të shoqëruar ose ndaluar nga policia janë: 1. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ): Kjo konventë është dokumenti kryesor që përcakton të drejtat dhe liritë themelore të individëve, përfshirë mbrojtjen kundër arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare (Neni 5). Personat e ndaluar kanë të drejtën të informohen për arsyen e arrestimit dhe të kenë qasje te një avokat. 2. Raportet e CPT-së shpesh theksojnë rëndësinë e trajtimit të duhur të personave të ndaluar dhe vëzhgimit të kushteve të mbajtjes së tyre në komisarate. 3. Këshilli i Europës ka rekomanduar që të gjitha shtetet anëtare të sigurojnë që të drejtat e personave të ndaluar të jenë të qarta dhe të dokumentuara, duke përfshirë qasjen te një avokat, mbrojtjen nga keqtrajtimi, dhe të **drejtën për ndihmë mjekësore**. Këto udhëzime janë pjesë e qasjes më të gjerë për të garantuar që personat e shoqëruar ose të arrestuar të kenë akses në një proces të drejtë ligjor.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së këtyre rasteve është mos instruktimi i vazhdueshëm dhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se qëndrimet jo ligjore të mbajtura në këto raste nga punonjësit e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”*, dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, ku thuhet se: *“i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale”*:

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ***si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend***, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikave të lartpërmendura, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar nga punonjësit e policisë në orët e para të shoqërimit.

Rekomandime

1. Marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre në momentet e para të shoqërimit nga Punonjësit e Policisë.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin e kriterëve të shoqërimit të shtetasve dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar si dhe ushtrimit nga titullarët të kërkesave rigoroze llogarie për zbatim të procedurave në rastet e shoqërimit të personave.
3. Marrja e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që çdo shoqërim i personave në ambientet e policisë së shtetit të jetë bazuar në ligjin për policin e shtetit i cili ka përcaktuar qarte se : **Në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimit human në këto ambiente.**
4. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë.
5. Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, lutemi të vihem në dijeni brenda një afati të përshtatshëm.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v